



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:029846

Datë: 08.08.2018

Numri i dokumentit: 00098716

**Pnr.647//17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.Rr. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, të asgjësimit apo të dëmtimit të pasurisë ,nga neni 333 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë,me numër PP/II.nr.1240/2017, të datës 29.09.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën **08.08.2018** në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

]

I akuzuari **D.RR.**, i biri i M., i nënës R, e gjinisë M, data e lindjes . . . në Gjakovë, ku dhe tani banon në rrugën "...", ka të kryer fakultetin, me profesion kamarier, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:** Më datën 16.08.2017 rreth orës 05:30 min.në rrugën“...”në Gjakovë,, dëmton bënë të pa përdorshme pasurinë e personit tjetër, të dëmtuarës **Ë. M.** në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes paraprake mes tyre, pasi që i pandehuri e akuzonte të dëmtuarën se kohë më parë i është përzier në lidhjen e tij me të dashurën **D.M.**, ditën kritike i revoltuar nga kjo i pandehuri **D.**, me çekan e thenë xhamin e lokalit pronë e të dëmtuarës, të cilës sipas deklaratës së saj i shkakton dëme material rreth 400 euro.

- me çka ka kryer veprë penale, asgjësim apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 par.1 KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17 par.1,41,49,50,51,52 ,73 dhe nenit 333 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës., i shqipton;

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4(**katër**) **muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(**një**) **viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara **Ë. M. nga Gjakova, Rr.”....”pn.**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1240/2017, të datës 29.09.2017, kundër të akuzuarit D.Rr. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, të asgjësimit apo të dëmtimit të pasurisë ,nga neni 333 par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari D.Rr. në shqyrtim fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, dhe menjëherë pas rastit të dëmtuarës **Ë. K.** i kam kërkuar falje, këtë vepër e kam kryer në afekt, kam qenë shumë nervoz dhe në atë moment nuk i kam menduar pasojat e kryerjes së veprës, dëmin e shkaktuar ia kam kompensuar të dëmtuarës në shumë prej 150 euro, pas këtij momenti me të dëmtuarën nuk kam pasur ndonjë mosmarrëveshje, shton se jam në gjendje të dobët materiale , punoi si kamerier, kontriboj në familje si dhe për herë të parë paraqitem në Gjykatë për një vepër të kryer penale, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysht këto rrethana me rastin e shqyrtimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe e njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari D. Rr.: Më datën 16.08.2017 rreth orës 05:30 min.në rrugën“....”në Gjakovë,, dëmton bënë të pa përdorshme pasurinë e personit tjetër, të dëmtuarës **Ë. M.** në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes paraprake mes tyre, pasi që i pandehuri e akuzonte të dëmtuarën se kohë më parë i është përzier në lidhjen e tij me të dashurën D.M, ditën kritike i revoltuar nga kjo i pandehuri D., me çekan e thenë xhamin e lokalit pronë e të dëmtuarës, të cilës sipas deklaratës së saj i shkakton dëme material rreth 400 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor, vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që

përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e dobët ekonomike të tij, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën e tillë penale apo të ngjashme, pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykatë, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, mos dënushmërinë e tij të mëparshme, si rrethana rënduese Gjykata muarr rrethanat në të cilat është kryer vepra, motivet për kryerjen e veprës, andaj Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimeve të procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**P. nr.647/17 më datë 08.08.2018.**

**Sekretarja juridike,**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjyqësore**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:029846  
Datë: 08.08.2018  
Numri i dokumentit: 00098716